

GrCF: UKT Ujesjelles Kanalizime Tirane

Vendi:	Shqipëri
Numri identifikues i Projektit:	49161
Sektori i Biznesit :	Infrastruktura bashkiake dhe mjedisore
Lloji i Njoftimit	Sektori Publik
Kategoria Mjedisore	B
Data e synuar për bord	17 Janar 2017
Statusi:	Kaluar aprovimin final, ne pritje te vendimit te Bordit
Publikimi i PSD (Dokument Permbledhës i Projektit):	09 Gusht 2017

Përshkrimi i Projektit

Ofrimi i një huaje prej 30 milionë euro për Ujësjetës Kanalizime Tirana (UKT ose Kompania”) në dy Transhe; Transhi i parë prej 15 milionë euro (Transhi I) do të jetë i disponueshëm me nënshkrimin e marrëveshjes dhe transhi i dytë prej 15 milionë euro, i pa përcaktuar. Fondet e transhit të parë do të përdoren për: rritjen e kapacitetit të Ujësjetës të Bovillës dhe ii) për ndërtimin e një tubacioni të ri që do të transportojë ujë nga ujësjetësi i Bovillës në veri perëndim të qytetit të Tiranës përmes rënies së lirë.

Për fondet e Transhit 2 do të merret një vendim në një stad të mëvonshëm pasi të ketë përfunduar studimi për Burimet Strategjike Ujore të UKT. Studimi do të përcaktojë investimin më kosto eficient dhe të realizueshëm nga pikëpamja ekonomike që do të adresojë problemin e mungesës së ujit në Tiranë duke vlerësuar njëkohësisht opsionet strategjike si për kërkesën dhe ofertën. Opsionet për ofertën mund të përfshijnë zhvillimin e burimeve të reja ujore si Guri i Bardhë ndërsa opsionet për kërkesën mund të përfshijnë rehabilitimin rrjetit e ujësjetës të Tiranës dhe instalimin e matësve të rrjedhës/presionit ose një kombinim të opsioneve.

Projekti është një nën-projekt nën Platformën për Qytetet e Gjellbërta.

Objektivat e Projektit

Projekti synon të asistojë Kompaninë në: i) ofrimin e një sistemi të qëndrueshëm për furnizim me ujë për realizimin e objektivit të saj për të siguruar ujë 24 orë në vitin 2021 dhe ii) përmes reduktimit të kostos operacionale të Kompanisë duke ofruar ujë nëpërmjet rënies së lirë përkundrejt kostove të lartave të përdorimit të pompave zhytëse.

Ndikimi në Tranzicion

Impakti në tranzicion i projektit të propozuar do të realizohet si mëposhtë:

- Si një nën-projekt i Platformës për Qytete të Gjelbra, ky projekt do të mbështesë zhvillimin e Planit të Masave për Qytete të Gjelbra duke identifikuar standartet dhe klasifikimin e sfidave mjedisore për qytetin dhe duke u dhënë prioritet investimeve dhe veprimtarive të tjera që adresojnë këto sfida.
- Projekti përfshin përgatitjen e një kontrate të shërbimit publik midis UKT dhe qytetit të Tiranës për të rritur parashikueshmërinë dhe përgjegjësinë për UKT.
- Projekti është në përputhje me Programin për Tranzicionin në Ekonominë e Gjelbër.

Projekti përfshin një Program të Zhvillimit të Korporatës që do të ndihmojë UKT në përmirësimin e qëndrueshmërisë së saj operacionale dhe financiare.

Informacion për Klientin

UJESJELLES KANALIZIME TIRANE.

Përmbledhja e Financimit të BERZH

30,000,000.00 Euro

Kostoja Totale e Projektit

34,000,000.00 Euro

Përmbledhja Sociale dhe Mjedisore

Kategorizuar B në përputhje me Politikën Sociale dhe Mjedisore. Rritja e kapacitetit nga Ujësjellësi i Bovillës dhe ndërtimi i një tubacioni të ri nga Ujësjellësi i Bovillës në veri perëndim të Tiranës do të sigurojë përfitime të ndjeshme në komunitet duke kontribuar në arritjen e objektivit të UKT për ujë 24 orë pa ndërprerje deri në vitin 2021. Ky projekt do të ofrojë gjithashtu përfitime afatgjata për mjedisin duke reduktuar kostot e energjisë për transportimin e ujit në veri perëndimit të qytetit përmes metodës së rënies së lirë. Ky segment furnizohet aktualisht nga pompa zhytëse puse të shterueshme. Cdo impakti i kundërt mjedisor

apo social në të ardhmen do të konsiderohet si specifik për rastin dhe do mund të adresohet lehtësisht përmes masave parandaluese.

Për transhin e dytë do të vendoset në një stad të mëvonshëm pasi të përfundohet studimi për Burimet Strategjike Ujore të UKT. Studimi do të përcaktojë investimin më kosto eficient dhe të realizueshëm nga pikëpamja ekonomike që do të adresojë problemin e mungesës së ujit në Tiranë duke vlerësuar njëkohësisht opsionet strategjike për kërkesën dhe ofertën.

Vlerësimi i Aspekteve Sociale dhe Mjedisore do të zhvillohet nga konsulentë të jashtëm si pjesë e studimit të fizibilitetit (analizës së projektit) dhe do të përfshijë një analizë Mjedisore dhe Sociale për impaktet potenciale që lidhen me Transhin e parë të projektit. Vlerësimi i aspekteve sociale dhe mjedisore për transhin II do të fillojë kur përdorimi i fondeve të jetë përcaktuar dhe mund të përshijë një Vlerësim të Impaktit Mjedor dhe Social nëse gjykohet e arsyeshme.

Gjithashtu në kuadër të projektit do të zhvillohet një Plan Masash Mjedisore dhe Sociale dhe një Plan i Angazhimit të Grupeve të Interesit që do të përfshijë një mekanizëm për ankesat. Krahas kësaj informacioni mbi performancën mjedisore dhe sociale dhe një përmbledhje e Planit të Masave do t'ju shpërndahet grupeve të interesit.

Ky dokument (PSD) do të përditësohet kur të bëhen të njohura rezultatet e vlerësimit.

Bashkëpunimi Teknik

BERZH do të mobilizojë fondet nga donatorët për të mbështetur një bashkëpunim teknik si mëposhtë:

Pëpara nënshkrimit

- Transhi 1: Vlerësim Teknik Mjedor dhe Social që përfshin rishikimin e skicave ekzistuese dhe dokumentave të tjera të projektit (75, 000 Euro nga fondet e Bankës)
- Transhi 2: Studimi i Menaxhimit të Burimeve Ujore për të përcaktuar investimin më kosto eficient dhe të realizueshëm nga pikëpamja ekonomike që do të adresojë problemin e mungesës së ujit në Tiranë duke vlerësuar njëkohësisht opsionet strategjike si për kërkesën dhe ofertën. Opsionet për ofertën mund të përfshijnë zhvillimin e burimeve të reja ujore si Guri i Bardhë ndërsa opsionet e kërkesës mund të përfshijnë rehabilitimin rrjetit e ujësjellësit të Tiranës dhe instalimin e matësve të rrjedhës/presionit ose një kombimin të opsioneve (75, 000 Euro fonde nga vetë burimet e Bankës).

Pas nënshkrimit

- Programi i Zhvillimit të Korporatës (PZHK) dhe Programi i Angazhimit të Grupeve të Interesit.

Bashkëpunimi teknik do të i)mbështesë zhvillimin institucional në formën e përmirësimeve operacionale dhe financiare përmes zhvillimit të PZHK dhe do të ii)mbështesë përgatitjen dhe nënshkrimin e një kontrate për shërbimin publik midis Qytetit të Tiranës dhe UKT dhe iii) zbatimin e Programit të Angazhimit të Grupeve të Interesit. Kostot e parashikuara për këtë janë 200,000 Euro të përhira nën Platformën për Qytete të Gjëlbra për Programin e

Zhvillimit të Korporatës në nivel të Bashkëpunimit Teknik dhe do financohen nga donatorë ndërkombëtarë ose nga SSF.

Informacion mbi Kontaktin e Shoqërisë

Redi Molla

redimolla@gmail.com

+355 69 258 2402

www.ujesjellesitirane.al

Ujesjelles Kanalizime Tirane, Rruga Besim Daja, Tirane, Shqiperi

Mundësi biznesi

Për mundësi biznesi ose prokurime, kontaktoni klientin.

Për projekte të sektorit shtetëror vizitoni faqen e Prokurimeve të BERZH

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Për pyetje mbi projektet e BERZH që nuk lidhen me prokurimet:

Tel: +44 20 7338 7168; Fax: +44 20 7338 7380

Email: projectenquiries@ebrd.com

Politika e Informimit Publik (PIP)

PIP përcakton mënyrën se si BERZH jep informacion dhe këshillohet me grupet e saj të interesit në mënyrë që të promovojë rritjen e ndërgjegjësimit dhe kuptimin e strategjive, politikave dhe aktiviteteve të saj.

Teksti i PIP mund të gjendet në: <http://www.ebrd.com/about/policies/pip/index.htm>

Mekanizmi i Ankesave për Projektet (MAP)

BERZH ka krijuar Mekanizmin e Ankimimeve për Projektet (MAP) për të ofruar një mundësi për një shqyrtim të pavarur të ankesave nga një ose me shumë individë ose nga organizata për projektet e financuara nga Banka të cilat pretendohet të kenë shkaktuar ose që do të shkaktojnë efekte negative.

Rregullat e Proçedurës së MAP mund të shihen në:

<http://www.ebrd.com/about/integrity/irm/about/pcm.pdf>

Cdo ankesë sipas Mekanizmit të Ankesave për Projektet duhet të dërgohet brenda afateve të përshkruara në kodin e Rregullave dhe Proçedurave të MAP. Ju mund të kontaktoni për ndihmë stafin e MAP në (pcm@ebrd.com) nëse jeni të paqartë mbi vlefshmërinë e ankesës tuaj.